AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

DITARI MUJOR

Tetor, 2026/ Vol. 10



Adresa: Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë.
Tel:+355 (0) 42251001, www.aida.gov.al | e-mail: info@aida.gov.al





Nga potenciali te investimet cilësore

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) organizoi më 2 tetor, në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit në Tiranë, edicionin e parë të Future Hospitality Forum 2026, me moton "From Potential to Prestige – Inspiring Investment and Excellence".

Në ceremoninë e hapjes, Kryeministri Edi Rama theksoi se rritja e turizmit shqiptar kërkon tashmë më shumë cilësi, standarde dhe praninë e markave globale. Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, u ndal te faza e re e zhvillimit të turizmit, duke vënë në fokus rritjen e vlerës së çdo vizite dhe zgjatjen e sezonit. Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, theksoi rëndësinë e kapitalit njerëzor dhe cilësisë së shërbimit.

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Laura Saro, prezantoi shifrat kryesore të forumit: 13 grupe ndërkombëtare hotelerie, që përfaqësojnë 61 marka, nga të cilat vetëm tri janë aktualisht të pranishme në Shqipëri, si dhe rreth 100 projekte shqiptare të prezantuara për investim dhe partneritet.

Programi vijoi me dy panele profesionale, të përqendruara te zhvillimi i sektorit të mikpritjes dhe vala e ardhshme e investimeve. Në to morën pjesë përfaqësues të institucioneve, investitorë dhe marka ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e lartë u shoqërua me takime B2B, ku projektet shqiptare u prezantuan drejtpërdrejt para operatorëve dhe markave globale, duke krijuar mundësi konkrete bashkëpunimi.











Ceremonia e hapjes në FHF 2026



Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, çeli edicionin e parë të Future Hospitality Forum 2026, duke vënë në qendër investimet cilësore, partneritetet strategjike dhe ruajtjen e autenticitetit shqiptar.

Në fjalën e saj, ajo paraqiti synimin për ta kthyer potencialin e Shqipërisë në projekte konkrete dhe për ta forcuar pozicionin e vendit si destinacion konkurrues për investimet ndërkombëtare në turizëm. Laura Saro theksoi se mikpritja e vërtetë shkon përtej imazhit të bukur të një fotografie: "Mund të jetë një fotografi e bukur që të frymëzon të vish në Shqipëri, por kur njerëzit mbërrijnë, ata vënë re mirëseardhjen, shërbimin, ushqimin, dizajnin dhe detajet e vogla që ndihen të vërteta për vendin."



Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, mori pjesë në edicionin e parë të Future Hospitality Forum 2026, organizuar nga AIDA, dhe mbajti fjalën kryesore në ceremoninë e hapjes.

Pjesëmarrja e Kryeministrit pasqyron rëndësinë strategjike të turizmit për ekonominë shqiptare dhe vëmendjen institucionale ndaj investimeve në këtë sektor.

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj, përshëndeti pjesëmarrësit në Future Hospitality Forum 2026.



Në fjalën e saj, ajo theksoi rëndësinë e investimeve, inovacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat për zhvillimin e një industrie turistike konkurruese, që krijon vlerë të shtuar për ekonominë shqiptare dhe mundësi të reja për sipërmarrjen.

Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, z. Blendi Gonxhja, mbajti fjalën përshëndetëse në Future Hospitality Forum 2026, ku u trajtuan zhvillimi i turizmit shqiptar dhe forcimi i identitetit të vendit si destinacion ndërkombëtar.

Diversifikimi i ofertës turistike, rritja e standardeve të mikpritjes dhe promovimi i trashëgimisë natyrore e kulturore janë thelbësore për zhvillimin afatgjatë të sektorit.

Takimet B2B dhe B2G në Future Hospitality Forum 2026



Takimet B2B dhe B2G në Future Hospitality Forum 2026 bashkuan zhvillues shqiptarë, përfaqësues të markave ndërkombëtare të hotelerisë, investitorë dhe institucione publike. Në fokus ishin prezantimi i mbi 100 projekteve të gatshme për investim dhe identifikimi i mundësive konkrete për bashkëpunim.

Dialogu i drejtpërdrejtë synoi krijimin e partneriteteve strategjike, tërheqjen e operatorëve ndërkombëtarë dhe përafrimin e projekteve shqiptare me standardet globale të industrisë së mikpritjes, duke hedhur bazat për marrëveshje dhe investime të reja në Shqipëri.

Në takime morën pjesë përfaqësues të 61 markave ndërkombëtare, 13 grupeve të njohura hoteliere, si dhe arkitektë, zhvillues e aktorë të tjerë të sektorit.

Panelet e Future Hospitality Forum 2026



Panelet e Future Hospitality Forum 2026 bashkuan ekspertë, investitorë dhe përfaqësues të institucioneve publike e private.

Diskutimet u përqendruan te modelet e reja të turizmit, investimet cilësore dhe standardet e mikpritjes. Panelet tërhoqën pjesëmarrje të gjerë dhe angazhim aktiv nga publiku.

AIDA falënderon panelistët për kontributin, ekspertizën dhe diskutimet e vlefshme.

Norma e papunësisë, prill–qershor 2026



Sipas të dhënave më të fundit të INSTAT-it, norma e papunësisë në Shqipëri për periudhën prill–qershor 2026 ka rënë, duke sinjalizuar zhvillim pozitiv në tregun e punës.

📍 T2 2025: 8,5%
📍 T2 2026: 8,3%

Ulja me 0,2 pikë përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë pasqyron përmirësimin e treguesve të punësimit dhe një mjedis më të favorshëm për zhvillimin ekonomik dhe investimet.

Fluksi i investimeve të huaja direkte



Sipas të dhënave më të fundit të Bankës së Shqipërisë, tre sektorët që kontribuuan më shumë në fluksin e investimeve të huaja direkte (IHD) gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 ishin:

Aktivitetet e pasurive të paluajtshme | 53,3% e totalit
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit | 15,8% e totalit
Industria përpunuese | 8% e totalit

AIDA mirëpriti një delegacion biznesi nga Turqia





Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) u takua me një delegacion biznesi nga Turqia, të kryesuar nga DEİK – Bordi për Marrëdhëniet Ekonomike me Jashtë të Turqisë. Takimi u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ekonomik dhe promovimit të mundësive për investime në Shqipëri.

Në takim morën pjesë përfaqësues të kompanive turke, përfshirë Ziraat Bank, SEKA Investment, Trans-Atlantic Strategic Programs Association (TASP) dhe Achar Energy / Eksim. Diskutimet u përqendruan te energjia, infrastruktura, ndërtimi dhe shërbimet financiare.

Nga pala shqiptare morën pjesë Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, dhe Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo. Ata diskutuan me delegacionin mundësitë e bashkëpunimit dhe investimit në sektorë me potencial të lartë për Shqipërinë. Takimi krijoi një bazë për vijimin e komunikimit dhe ndjekjen e interesave të shprehura nga kompanitë, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.



AIDA në Balkan Business Forum 2026



Balkan Business Forum 2026: AIDA promovon inovacionin dhe forcon lidhjet tregtare mes Shqipërisë dhe Turqisë
Në Pallatin e Kongreseve në Tiranë u zhvillua Forumi i Biznesit Ballkanik. Aktiviteti, i organizuar nga ATTSO – Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri–Turqi, bashkoi biznese, investitorë dhe përfaqësues institucionalë nga pesë vende: Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Turqia.

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, mori pjesë në Panelin 02: "Technology & Innovation Ecosystems". Ajo theksoi se Shqipëria dhe Turqia kanë një bazë të fortë bashkëpunimi, e cila mund të thellohet përmes partneriteteve që nxisin inovacionin në sektorë kyç si turizmi, bujqësia, logjistika dhe energjia.

Gjatë fjalës së saj, znj. Saro nënvizoi se inovacioni duhet të shndërrohet nga koncept teorik në mjet për rritjen ekonomike.

Përmes takimeve dhe dialogut, AIDA riafirmoi angazhimin për të lidhur investitorët, sipërmarrjet dhe institucionet, si dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit dhe integrimin e tij në zinxhirët rajonalë të vlerës.

Stenda e AIDA-s mirëpriti gjatë ditës vizitorë dhe përfaqësues biznesi, të cilët shprehën interes për mundësitë e investimit dhe klimën e biznesit në Shqipëri.





BRIDGE2EU "Menaxho" | Workshop III

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Brain Nest Institute, zhvilloi Workshop-in III të programit BRIDGE2EU – From Local Potential to European Opportunities, kushtuar menaxhimit të projekteve të financuara nga BE-ja.
Workshop-i III i BRIDGE2EU, me temë "Menaxho", mblodhi ekspertë dhe pjesëmarrës për të trajtuar tri shtyllat kryesore të menaxhimit të projekteve europiane: zbatimin dhe raportimin, menaxhimin financiar e buxhetimin, si dhe procedurat e prokurimit PRAG.



Me shembuj praktikë dhe diskutime të hapura, pjesëmarrësit u njohën me mënyrat e menaxhimit profesional, transparent dhe efektiv të fondeve të BE-së.



Workshop-i u drejtua nga tre ekspertë, të cilët trajtuan temat e mëposhtme:

- Enxhi Lipa | Themeluese dhe drejtuese ekzekutive, Brain Nest Institute: menaxhimi i projekteve të BE-së, cikli i zbatimit, marrëveshjet e grantit, planifikimi i aktiviteteve, monitorimi i rezultateve dhe raportimi.

- Valmira Kallushi | Eksperte e menaxhimit financiar: planifikimi dhe monitorimi i buxhetit, kostot e pranueshme, dokumentacioni financiar, fluksi i parasë, raportimi dhe auditimi.

- Migena Kalthi Karaj | Eksperte e prokurimit dhe PRAG: parimet dhe procedurat PRAG, llojet e kontratave, dokumentacioni i tenderimit, vlerësimi i ofertave dhe kontraktimi.



Dëshironi ta përgatisni biznesin tuaj për mundësitë e financimit nga BE-ja?

Ndiqni aktivitetet e ardhshme të BRIDGE2EU dhe bëhuni pjesë e programit që e kthen potencialin e biznesit tuaj në mundësi konkrete zhvillimi!

AIDA ju informon për thirrjen e re: Programi i Granteve për Fuqizimin e Bashkëpunimit Rajonal (ERC)

AIDA vijon të informojë palët e interesuara për skemat e reja financiare dhe programet e trajnimit që mbështesin ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.
Në portalin "Akses në Financë" gjeni thirrjen për Programin e Granteve për Fuqizimin e Bashkëpunimit Rajonal (ERC).

Për informacion mbi thirrjen, kushtet e pranimit dhe hollësi të tjera, vizitoni platformën:

https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/programi-i-granteve-per-fuqizimin-e-bashkepunimit-rajonal-erc



AIDA ju informon për thirrjen e re: Financial Support to Startups Open Call

Në portalin "Akses në Financë" është publikuar thirrja Financial Support to Startups Open Call, për mbështetjen e start-up-eve.

Për informacion mbi thirrjen, kushtet e pranimit dhe hollësi të tjera, vizitoni platformën:

https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/financial-support-to-startups-open-call



Ftesë për pjesëmarrje në IIFME 2027 – Kuvajt

Nga 31 janari deri më 3 shkurt 2027, në Kuvajt do të zhvillohet edicioni i 17-të i Panairit Ndërkombëtar të Shpikjeve në Lindjen e Mesme (IIFME), organizuar nga Kuwait Science Club në partneritet me Ekspozitën Ndërkombëtare të Shpikjeve të Gjenevës.

IIFME bashkon shpikës, inovatorë, sipërmarrës, investitorë dhe aktorë të ekosistemit të inovacionit. Panairi krijon mundësi për prezantimin e shpikjeve dhe zgjidhjeve inovative, krijimin e kontakteve dhe zhvillimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Start-up-et, sipërmarrësit, shpikësit, kërkuesit dhe inovatorët shqiptarë të interesuar ftohen të njihen me mundësitë e pjesëmarrjes dhe aplikimit.

Organizatorët parashikojnë çmime në para me vlerë totale mbi 65 000 USD për pjesëmarrësit dhe shpikjet e vlerësuara.

Për informacion mbi kriteret dhe procedurat e regjistrimit:
registration@iifme.com
www.iifme.com

AIDA inkurajon subjektet shqiptare të inovacionit dhe sipërmarrjes ta shfrytëzojnë këtë mundësi për promovim, rrjetëzim dhe ndërkombëtarizim.



Ftesë për pjesëmarrje në "Bridge to Balkans" në Tiranë!

AIDA ftoi studentët universitarë, sipërmarrësit e rinj, inovatorët dhe themeluesit e start-up-eve në fazat e hershme të aplikojnë për këtë mundësi zhvillimi.

Programi i përshpejtimit "Bridge to Balkans" (B2B), i iniciuar nga Dijitalpark Teknokent, vjen për herë të parë në Tiranë. Ai synon të bashkojë sipërmarrës të rinj nga i gjithë Ballkani dhe t'u ofrojë mbështetje për t'i kthyer idetë e tyre në biznese.

Çfarë përfshin programi?

· 5 nëntor | Startup Bootcamp (Tiranë)
· Dy javë mentorim dhe zhvillim pas bootcamp-it
· 11 dhjetor | Grand Final Demo Day (Shkup): start-up-et më premtuese do të garojnë në finalen në Maqedoninë e Veriut.

Pse të aplikoni?
Programi ofron mundësinë për t'i kthyer idetë në ndërmarrje, për të zgjeruar rrjetin përtej kufijve dhe për t'u bërë pjesë e ekosistemit të sipërmarrjes në Ballkan.

Udhëtimi i një start-up-i mund të nisë në Tiranë dhe të vijojë deri në finalen në Shkup.

Aplikoni tani:
https://app.smartsheet.eu/b/form/01a03d59dd5874808c6633af004d71c1
Mësoni më shumë: www.bridge2balkans.org

Aplikoni për të çuar projektin tuaj përtej kufijve!



Ftesë për pjesëmarrje në Shenzhen Toy, Baby & Licensing Fair 2027

AIDA fton bizneset shqiptare që operojnë në fushën e lodrave dhe produkteve për foshnja e fëmijë të marrin pjesë si vizitorë profesionistë në Shenzhen Toy, Baby & Licensing Fair 2027. Panairi do të zhvillohet nga 31 marsi deri më 2 prill 2027 në Shenzhen të Kinës, pranë Aeroportit Ndërkombëtar të Shenzhenit.

Panairi do të bashkojë mbi 1 400 prodhues dhe zotërues markash, në një sipërfaqe ekspozimi prej 130 000 m², duke ofruar mundësi për kontakte të drejtpërdrejta me furnitorë dhe partnerë të rinj.

Pjesëmarrësit do të njihen me tendencat më të fundit në lodrat inteligjente me inteligjencë artificiale, lodrat edukative STEAM, produktet për foshnja dhe licencimin. Organizatorët ofrojnë gjithashtu takime biznesi të personalizuara, shërbime përkthimi dhe aktivitete rrjetëzimi pa pagesë.
Për më shumë informacion: https://en.chinatoyfair.com



Shqipëria merr pjesë për herë të parë në ProWine Shanghai 2026

Me rrënjë në traditë, varietete autoktone dhe një brez të ri prodhuesish vere, Shqipëria po përgatitet të prezantojë pasurinë dhe potencialin e saj në një nga panairet më të rëndësishme ndërkombëtare të industrisë së verës.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) organizon Pavijonin Kombëtar Shqiptar, ku gjashtë kantina vendase do të prezantojnë verërat e tyre dhe veçantitë e një vendi që meriton të zbulohet më shumë nga tregjet ndërkombëtare.

📍 Shanghai, Kinë
📅 10–12 nëntor 2026
Discover Albania Through Its Wines.



Gjashtë kantina, një prezantim i verës shqiptare në ProWine Shanghai 2026!

AIDA mbështet pjesëmarrjen e gjashtë kantinave shqiptare, të cilat prezantojnë produktet, historitë dhe përvojën e tyre para profesionistëve të industrisë së verës nga tregje të ndryshme të botës.

Gjashtë kantinat në Pavijonin Kombëtar Shqiptar:

- Kantina Arbëri
- Kantina Belba 2000
- Kantina Caco
- Kantina Enofama
- Kantina Shehi Family
- Kantina Arianiti

Nga varietetet autoktone te ndërthurja e traditës me teknikat moderne të prodhimit, secila kantinë sjell identitetin dhe veçantinë e saj. ProWine Shanghai krijon mundësi për kontakte të reja me importues, distributorë, rrjete tregtare dhe profesionistë të sektorit HoReCa, si dhe për bashkëpunime e zgjerim të eksporteve shqiptare drejt tregjeve aziatike.

📍 ProWine Shanghai, Kinë
📅 10–12 nëntor 2026

